

VENDIM
Nr. 16, datë 12.1.2018

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEPRIMTARIVE QË USHTROJNË NDËRMARRJET SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Veprimtaritë e ushtruara nga ndërmarrjet sociale kontribuojnë në përmbushjen e objektivave sociale të sipërmarrjes, si: promovimi i përfshirjes sociale të kategorive në nevojë në këto veprimtari, inkurajimi i punës vullnetare, përfshirja e të rinjve në këto veprimtari, përmirësimi i kapaciteteve të shoqërisë për të ndërmarrë veprimtari novatore, që adresojnë çështjet sociale, ekonomike dhe mjedisore.

2. Veprimtaritë e ushtruara nga ndërmarrjet sociale krijojnë mundësi të reja për punësim dhe një mjedis inkurajues për integrimin social e riintegrimin profesional të grupeve të pafavorizuara në tregun e punës.

3. Ndërmarrjet sociale e ushtrojnë veprimtarinë në nivel lokal, duke ofruar mallra e shërbime në përputhje me nevojat e komunitetit dhe në kuadër të parimit të deinstitutionalizimit të funksioneve të njësisë së qeverisjes vendore.

4. Veprimtaria e ndërmarrjeve sociale përfshin fushën e shërbimeve shoqërore, shëndetësore, kulturore e arsimore, të promovimit të turizmit e mbrojtjes mjedisore, si dhe veprimtari të ndërmjetësimit e kualifikimit për punësim. Këto veprimtari zhvillohen si më poshtë vijon:

a) Në fushën e shërbimeve shoqërore, veprimtari që lidhen me shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen në qendrat rezidenciale, qendrat ditore, në shtëpi dhe në komunitet, sipas parashikimeve ligjore përkatëse;

b) Në fushën e shërbimeve shëndetësore, veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit, të aktiviteteve fizike e sporteve amatore, për qëllim socializimi e argëtimi;

c) Në fushën e promovimit të turizmit, shërbime në bar-restorante-hoteleri, guida turistike dhe shërbime të turizmit social për personat, të cilët nuk kanë mundësi të vizitojnë atraksionet turistike për shkak të kushteve shëndetësore ose të jetesës;

ç) Në fushën e veprimtarive kulturore, veprimtari që lidhen me artin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre;

d) Në fushën e mbrojtjes mjedisore, veprimtari që lidhen me ruajtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi nga aktiviteti njerëzor dhe veprimtaritë ekonomike, për të garantuar një mjedis të shëndetshëm për qytetarët;

dh) Në fushën e kualifikimit dhe të ndërmjetësimit për punësim, veprimtari për promovimin e trajnimit profesional, veprimtari edukative e të ndërmjetësimit për punësim për personat që përfshihen në kategoritë e grupeve të pafavorizuara.

5. Ndërmarrjet sociale kryejnë edhe veprimtari tregtimi mallrash apo shërbimesh, të ofruara nga veprimtari të ndërmarrjeve të tjera sociale, produkte për personat e pafavorizuar, produkte të prodhuesve të vegjël nga zona të thella apo të pafavorshme nga ana mjedisore, si dhe të tjera veprimtari në mbështetje të ndërmarrjeve të tjera sociale.

6. Në fushën e prodhimit, ndërmarrjet sociale kryejnë veprimtari që lidhen me prodhimin artizanal të një game të gjerë mallrash e produktesh që i shërbejnë komunitetit dhe, veçanërisht, produktesh që kanë për qëllim krijimin e lehtësive për personat e pafavorizuar.

7. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama